



**Albanian Media Institute
Instituti Shqiptar i Medias**



MONITORIM

PËR
ZBATIMIN
E LIGJEVE
PËR SHPIFJEN
DHE
FYERJEN

Tiranë 2015



This project is funded
by the European Union



Albanian Media Institute
Instituti Shqiptar i Medias

[Monitorim për zbatimin e ligjeve për shpifjen dhe fyerjen]

Ky dokument është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Europian. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësia e vetme e Institutit Shqiptar të Medias dhe në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet se pasqyron pozicionin e Bashkimit Europian.

Tiranë, 2015

Hyrje

Pas firmosjes së Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit (MSA) me Bashkimin Europian në 12 qershor 2006, integrimi në BE ka qenë ndër prioritetet më të larta për qeveritë shqiptare. Synimi për të hyrë në BE u kthye në një motor reforme, ndërsa MSA shërbeu si katalizator për ndryshime konkrete. Në këtë kontekst, harmonizimi i legjislacionit shqiptar me standartet dhe legjislacionin e BE ishte një nga fushat ku nevojitej reformë urgjente në vend, përfshi këtu edhe legjislacionin për shpifjen dhe fyerjen, të cilat rregulloheshin në një mënyrë të konsideruar si kërcënuese për lirinë e shprehjes nga organizatat që fokusohen te liria e shprehjes dhe e medias.

Pas një periudhe lobimi që zgjati disa vjet, organizata të shoqërisë civile arritën të propozojnë në parlament amendamentet e Kodit Penal dhe Kodit Civil, propozime të cilat u miratuan në fillim të vitit 2012. Këto ndryshime ishin të rëndësishme, pasi përmirësuan standardin e garancisë për lirinë e fjalës, ndërkohë që qartësoi kriteret që duhet të ketë parasysh gjykata para se të marrë vendim dhe të japë dëmshpërblim për reputacion të njollosur.

Si është situata e zbatimit të këtyre ligjeve tre vite më vonë? Cila ka qenë praktika e gjykatave shqiptare në këtë aspekt? Çfarë prirje kanë gjykatat në rastet kur e akuzuar është media apo gazetarët? Cilat janë rrethanat që të çojnë në këto vendime? Ky monitorim ka për qëllim të trajtojë këto pyetje, duke filluar nga një vështrim për kriteret që mendohen se duhet të ketë legjislacioni për shpifjen dhe fyerjen, në legjislacionin aktual shqiptar në këtë fushë, si dhe në vështrimin në praktikë si është zbatuar ky ligj për median në gjykata.

➤ **Kriteret e rregullimit për shpifjen dhe fyerjen**

Nuk ekziston rregullim i përbashkët në BE për ligjet e shpifjes dhe fyerjes. Në vend të kësaj, fryma e përgjithshme në këtë fushë është vendosur nga Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore. Në të njëjtën kohë, ky dokument themelor përbën edhe bazën për punën dhe jurisprudencën e shqyrtuar nga Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut. Ky dokument përpiqet të garantojë plotësisht lirinë e shprehjes si një të drejtë njerëzore themelore dhe në të njëjtën kohë ruan edhe dinjitetin njerëzor kundër shpifjes dhe shkeljeve të tjera të ngjashme. Më konkretisht, neni 10 i përkushtohet respektit për lirinë e shprehjes si një të drejtë themelore dhe të patjetërsueshme:

“Çdo person ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e opinionit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione ose mendime pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që të vendosin një regjim autorizimesh për institucionet e radiodifuzionit, të kinemasë, ose të televizionit.”

Si mund të shihet, paragrafi i parë i këtij neni mishëron të drejtën e pamohueshme për lirinë e shprehjes, duke theksuar nevojën që autoritetet nuk duhet të imponohen, të ndikojnë ose kufizojnë këtë të drejtë. Në këtë kontekst, ky nen themelor i Konventës, sidomos për fushën e medias, garanton të drejtën për lirinë e shprehjes dhe lirinë e marrjes së informacionit.

Megjithatë, si ndodh në çdo rast, kjo e drejtë vjen edhe me kufizimet përkatëse, në mënyrë që të mos konfliktojë me të drejta të tjera dhe të arrihet një ekuilibër i përshtatshëm. Më konkretisht, paragrafi i dytë i të njëjtit nen thotë:

“Ushtrimi i këtyre lirive, që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t’u nënshtrohet disa formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara nga ligji që, në një shoqëri demokratike, përbëjnë masat e nevojshme për sigurimin kombëtar, integritetin territorial ose sigurimin publik, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për ruajtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e informatave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.”

Pra, paragrafi i dytë vendos qartë disa kufizime për lirinë e shprehjes të cituar më parë, në mënyrë që kjo e drejtë të mos përplaset me interesin publik, si siguria kombëtare, siguria publike, parandalimi i krimit, apo mbrojtja e shëndetit dhe moralit. Ajo që ka më shumë rëndësi për ligjin për shpifjen dhe fyerjen nën shqyrtim këtu, ky paragraf kufizon ushtrimin e lirisë së shprehjes “për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve.” Për rrjedhojë, ligjet për shpifjen dhe fyerjen në vendet që janë palë të Konventës, përfshirë edhe Shqipërinë, duhet të përpiqen të arrijnë këtë ekuilibër delikat, por të domosdoshëm midis këtyre të drejtave themelore.

➤ **Legjislacioni shqiptar për shpifjen dhe fyerjen¹**

Në fillim të vitit 2012, Shqipëria miratoi reforma të plota të ligjeve të saj civile dhe penale për shpifjen, duke i harmonizuar ato shumë më tepër me standardet demokratike evropiane. Reformat përfaqësonin kulmin e shumë viteve lobim nga aktorë vendas dhe ndërkombëtarë, të shtrira në kohëzgjatjen e tri legjislatrave radhazi. Ato janë gjithashtu një studim interesant rasti të një përpjekjeje afatgjatë për të prodhuar shtysën politike për reforma politikisht të pakëndshme: ndryshimet e ligjeve për shpifjen janë tejet të vështira të arrihen në demokraci të reja (dhe ndonjëherë të vjetra) pasi shpesh perceptohen nga klasa politike si çështje mbijetese personale e politike.

¹ Përmbledhja e legjislacionit shqiptar për fyerjen dhe shpifjen dhe për procesin e amendimit të këtij legjislacioni është kontribut i Darian Pavlit “Vrapimi i maratonës: përpjekje për të reformuar ligjet e Shqipërisë për shpifjen,” prill 2013, <http://institutemedia.org/Documents/PDF/D.Pavli%20shqip%20follow-up.pdf>

Amendamentet specifike u hartuan dhe promovuan, për më shumë se shtatë vjet, nga Instituti Shqiptar i Medias (ISHM) dhe Nisma për Drejtësi e Shoqërisë së Hapur (OSJI) – me ndihmën e shumë aktorëve të tjerë, përfshirë mediat dhe shoqërinë civile vendase, deputetë me mendësi të ngjashme nga të dyja anët e spektrit politik, si dhe një sërë institucionesh evropiane që kanë shqyrtuar ligjet dhe praktikat lidhur me shpifjen në vend gjatë viteve. Këmbëngulja e Komisionit Evropian mbi nevojën për reforma ishte veçanërisht e rëndësishme, duke pasur parasysh ndikimin e Komisionit në një vend të etur për të marrë statusin e kandidatit për anëtarësim në BE.

Ky dokument përfshin një pasqyrë të shkurtër të ligjit dhe praktikave lidhur me shpifjen në vitet e fundit, pasuar nga një përshkrim i përpjekjeve të avokatisë në mbështetje të reformave si dhe një përmbledhje të amendamenteve të miratuara. Materiali përfundon me disa komente mbi efektet e mundshme të reformave.

➤ **PROCESI I REFORMËS: NJË SAGA SHTATËVJEÇARE**

Në fund të vitit 2004, ISHM dhe SHHID hartuan versionin e parë të propozimeve për reforma, të cilat u miratuan dhe u futën në procesin legjislativ nga një grup dypartiak deputetësh – një rast mjaft i pazakontë në parlamentarizmin shqiptar, ku shumica dërrmuese e nismave legislative vijnë nga dega ekzekutive. Megjithatë, përpara se të shqyrtohej propozimi përfundoi mandati i legjislaturës, në atë kohë në duart e Partisë Socialiste (PS) të Fatos Nanos, pikërisht në verën e vitit 2005. Një sfidë e vazhdueshme (dhe mbase edhe një bekim) për reformat ishte fakti që ato kërkonin mbështetjen e të dy partive kryesore meqenëse Kushtetuta e Shqipërisë kërkon një shumicë prej tre të pestash për ndryshimet në kodet civile dhe penale, të cilat janë ato që rregullojnë përgjegjësitë civile dhe penale për shpifjen.

Zgjedhjet e Korrikut 2005 risollën në pushtet Partinë Demokratike. Një nga vendimet e para i Kryeministrit të rikthyer Sali Berisha ishte që ndaloi të gjithë zyrtarët e lartë të qeverisë të ngrinin padi ndaj medias për shpifje. Ndërkohë që vlefshmëria ligjore e një vepre të tillë ishte e diskutueshme, synimi ishte të sinjalizohej një largim çështjet e zhurmshme të shpifjeve gjatë periudhës së Nanos dhe për shumë vite, zyrtarët e PD-së përgjithësisht iu përmbajtën.² Rasti ishte gjithashtu një kujtesë se si çështjet e lirisë të medias kanë gjeneruar teatër politik në skenën politike shumë partiake të Shqipërisë në dy dekadat e fundit. Vetëm pak vite më parë, PS-ja ishte distancuar nga një ligj shtypi thellësisht i kritikuar, miratuar nga qeveria e mëparshme e Berishës, duke shfuqizuar të gjitha dispozitat e tij, me përjashtim të nenit të parë, i cili shpallte se "shtypi është i lirë."

² Në dy vitet e fundit, ministra, anëtarë të parlamentit të PD-së dhe anëtarë të familjes së Berishës kanë ngritur një numër çështjesh të zhurmshme për shpifje kundër deputetëve dhe zyrtarëve të PS-së.

Në dhjetor 2006, propozimet e ISHM/NDSHH për reformën lidhur me shpifjen iu riparaqitën parlamentit të kontrolluar nga PD-ja, prapë me mbështetjen e një grupi deputetësh nga të dy krahët politikë. Megjithatë, në maj të vitit 2007, me një lëvizje të papritur, qeveria Berisha e miratoi propozimin e reformës si të vetin dhe ia dërgoi parlamentit për miratim si nismë e ekzekutivit.³ Lëvizja dukej se kishte efektin e kundërt sepse grupi i PS-së, i cili kishte pasur rezerva për propozimin e shoqërisë civile që nga fillimi, vendosi të mos e mbështeste me qëllim që të mos i jepte PD-së shansin që të dukej si kampione e fjalës së lirë.

Në mes të vitit 2009, pas rezultatit më të ngushtë zgjedhor prej vitit 1991, PD-ja fitoi një mandat të dytë falë një aleance surprizë me Lëvizjen Socialiste për Integrim të Ilir Metës. Ndërkohë, Komisioni Evropian, Këshilli i Europës dhe vëzhguesi i mediave lira pranë OSBE-së, ndër të tjera, vazhduan të kërkonin reforma të ligjit për shpifjen; Komisioni e ngrinte vazhdimisht këtë çështje në fushat e raportit vjetor (raporti i progresit) mbi pajtueshmërinë e Shqipërisë me kriteret e BE-së. Në fund të vitit 2011, u shfaq një mundësi e rrallë, pas një shkrirjeje në marrëdhëniet qeveri-opozitë ku përfshihej angazhimi (në retrospektivë, afatshkurtër) për të miratuar legjislacion me rëndësi të veçantë për integrimin evropian. ISHM dhe NDSHH bënë një tjetër përpjekje për amendamentet për shpifjen, të cilat qeveria e PD-së tashmë i kishte miratuar në parim; opozita i largoi kundërshtimet dhe, me disa ndryshime, ofroi votat e nevojshme për t'i miratuar në fund të shkurtit dhe fillim të marsit 2012.

Përveç sfidave politike, është interesante të vihen në dukje kundërshtimet e një pjese të mirë të ngrehinës ligjore ndaj reformave lidhur me shpifjen, dhe sidomos shfuqizimin e shpifjes penale. Për shembull, Ministria e Drejtësisë, e konsideruar prej kohësh si "kujdestar i kodeve" në traditën napoleonike të vendit, ishte vazhdimisht armiqësore ndaj ndryshimeve, pavarësisht përkatësisë politike të ministrit. E njëjta gjë mund të thuhet për një pjesë të konsiderueshme të profesionistëve ligjorë dhe akademik, të cilët mbeten skeptikë mbi përparësinë e të drejtave dhe vlerave "të reja" kushtetuese, si liria e fjalës, mbi rregullimin tradicional të çështjeve penale dhe civile. Në këtë kuptim, konstitucionalizimi i ligjit të zakonshëm – një proces sizmik që shumica e Europës Perëndimore e kaloi në dekadat pas vitit 1945 – është larg përmbushjes në Shqipëri. Një lloj i tillë skepticizmi shfaqej me forcë hera-herës në debatet më të fundit parlamentare, dhe është shkak për disa nga kompromiset që u arritën (p.sh. vendimi për të ruajtur shpifjen si një kundravajtje penale ose për të holluar disa nga mbrojtjet në kontekstin civil).⁴

As reputacioni popullor i mediave lokale, të cilat shihen gjerësisht (me të drejtë apo gabimisht) si të anshme, joprofesionale dhe "ndoshta më të lira se ç'duhet të jenë," nuk ka ndihmuar. Nëse kjo nuk ndryshon me kalimin e kohës, mund të bëhet e vështirë që reformat e 2012 të mbahen

³ Shih Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) të 4 Maj 2007.

⁴ Një kundërshtim që është veçanërisht shqetësues lidhet me një dispozitë të propozuar që do të kishte bërë të vërtetë një mbrojtje të plotë për raste të shpifjeve civile (dëm të reputacionit). Dispozita është marrë nga versioni përfundimtar, i cili thjesht u kërkon gjykatave të marrin në konsideratë, bashkë me faktorë të tjerë, nëse akuzat ishin të vërteta.

në kode, kur Shqipëria të mos ketë më nevojë të përshtatet me këmishën e forcës së kritereve për integrim të BE.

➤ **AMENDAMENTET: ÇFARË NDRYSHOI NË TË VËRTETË**

Ndryshimet në ligjet për shpifje penale dhe civile të miratuara nga Parlamenti në fillim të vitit 2012 ishin të konsiderueshme dhe në pjesën më të madhe pozitive. Ato mund të përmbliidhen si më poshtë—

-- mbi shpifjen penale:⁵

- Të tre nenet mbi shpifjen e zyrtarëve publikë, përfshirë presidentin e Republikës, u shfuqizuan plotësisht. Zyrtarët publikë nuk do të gëzojnë më ndonjë mbrojtje të veçantë, duke përfshirë mospërfshirjen e prokurorëve publikë, dhe duhet të veprojnë si qytetarë të zakonshëm.
- Fyerja (Neni. 119 KP) dhe shpifja (ose sharja, Neni. 120 KP) u mbajtën si shkelje, të dënueshme me gjobë. Burgimi hoq, por u rrit vlera maksimale e gjobës në 3 milionë lekë (21.000 Euro). Këto duhet të ndiqen penalisht privatisht, nga viktimi e pretenduar, si më parë, pa përfshirjen e policisë apo prokurorisë publike. Megjithatë, dënimi me secilin prej neneve, do të krijonte precedent penal.
- Amendamenti i Nenit. 120 sqaroi se, për t'u konsideruar fajtor për shpifje, i pandehuri duhet të ketë vepruar me "dijeni për falsitetin" e deklaratave shpifëse. Kjo është një stekë shumë e lartë për prokurorinë, nëse aplikohet si duhet nga gjykatat.
- Dy dispozita mbi fyerjet ndaj personalitete të huaja (neni 227) dhe përdhosjes së simboleve të shteteve të huaja (neni 229) po ashtu u shfuqizuan. Neni. 268 për përdhosjen e flamurit shqiptar apo himnit kombëtar u ndryshua për t'u zbatuar vetëm në rastet kur ndodhnin "gjatë një aktiviteti të organizuar nga autoritetet publike;" periodha maksimale e burgimit u shkurtua nga dy vjet në tre muaj.

-- mbi shpifjen civile:⁶

- Ndryshimet e nenit 625, i cili rregullon të gjitha format e dëmit moral, sqaruan se konsiderohet shkak për ndërmarrje veprimesh për dëmtim të nderit, reputacionit ose

⁵ Shih Ligjin Nr. 23/2012 mbi Disa Shtesa dhe Ndryshime të Kodit Penal (i miratuar në 1 Mars 2012, hyrë në fyqi në 11 Prill 2012)

⁶ Shih Ligjin Nr. 17/2012 mbi Disa Shtesa dhe Ndryshime të Kodit Civil (i miratuar në 16 Shkurt 2012, hyrë në fyqi në 29 Mars 2012)

personalitetit; u prezantuan shkaqe të reja për ndërmarrje veprimesh për shkelje të së drejtës së emrit (neni 625 (c)) dhe shkelje të privatësisë (neni 625 (ç)).

- Neni i ri 647/a paraqet kriteret për të vlerësuar nëse i pandehuri duhet të japë llogari për dëm të shkaktuar ndaj nderit ose reputacionit të dikujt, dhe nëse është kështu, për të përcaktuar nivelin e kompensimit. Si parim i përgjithshëm, çdo kompensim që jepet duhet të jetë proporcional dhe synon të "rivendosë të drejtën që është shkelur," në vend që të ndëshkojë të pandehurin.
- Dispozita e re përcakton njëmbëdhjetë faktorë specifikë dhe joshterues që duhet të merren parasysh nga gjykata në përcaktimin e përgjegjësisë. Këto përfshijnë: nëse pretendimet përbëjnë fakt apo opinion, nëse ata janë të vërteta / të rreme ose përbëjnë referime të sakta ndaj deklaratave të palëve të treta, nëse ato lidhen me "çështje të interesit publik, ose persona në funksione qeveritare apo kandidatë për zgjedhje;" dhe nëse autori ka vepruar në përputhje me ndonjë nga rregullat përkatëse të etikës profesionale (p.sh. në rastin e gazetarëve).
- Në lidhje me shumën e dhënë të kompensimit, gjykatat janë të detyruar të marrin në konsideratë nëse dëmshpërblimi "mund të përkeqësojë ndjeshëm gjendjen financiare të të paditurit". Kjo mund të zbatohet, për shembull, kur dëmshpërblimet e larta mund ta çojnë një media të vogël drejt falimentimit.
- Periudha e parashkrimit për ndërmarrjen e padive për shpifjen dhe privatësinë u reduktua nga tre vjet në një vit (Neni 115(e) CC).
- Amendamentet nuk janë prapavepruese; me fjalë të tjera, ato nuk aplikohen në çështjet në proces, por vetëm për rastet e reja të ndërmarra pas hyrjes së tyre në fuqi.

➤ Monitorimi i zbatimit të ligjit për shpifjen dhe fyerjen në praktikë

U desh një kohë e gjatë që të arrihej te amendimi i ligjeve për shpifjen dhe fyerjen. Gjithsesi, ky ndryshim u konsiderua shumë i rëndësishëm përse i përket lirisë së shprehjes dhe lirisë së medias, duke bërë një hap përpara në legjislacionin shqiptar që garanton këtë liri themelore. Kjo jo vetëm për garantimin në letër dhe harmonizimin e legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Europian, po sidomos për të parandaluar abuzimet e vërejtura më parë me aplikimin e ligjit për shpifjen në gjykatë si dhe për të garantuar në një mënyrë më të qartë lirinë e shprehjes, duke ruajtur të drejtën e reputacionit të panjollësuar.

Nuk ka shumë monitorime dhe studime të mënyrës se si është përdorur legjislacioni për shpifjen dhe fyerjen në Shqipëri, në mënyrë që të krahasohet në mënyrë të saktë dhe të

hollësisht zbatimi i ligjeve të mëparshme me ndryshimet e bëra në vitin 2012. Gjithsesi, në mënyrë të përmbledhur më poshtë vjen përvoja e njërit prej studiuesve të kësaj fushe, Darian Pavlit, në lidhje me prirjet kryesore të zbatimit të ligjeve për shpifjen dhe fyerjen:

LIGJET DHE PRAKTIKA E SHPIFJES KOHËT E FUNDIT⁷

Është shkruar shumë në lidhje me përdorimin e ligjeve për shpifjen – dhe sidomos ato të një natyre penale – për të ngacmuar ose për t’iu mbyllur gojën mediave e kundërshtarëve politikë në Shqipëri. Në vitet 1990 dhe fillim të viteve 2000, padi të tilla ishin të zakonshme dhe sillnin dëme të vërteta. Në 2002, hulumtova dhe shkrova një raport për Human Rights Watch që merrej hollësisht me raste të shpifjeve politike. Një rast që qëndron ende në mendje përfshinte një gazetar të ri i cili thërrijet rregullisht për t’u pyetur nga prokurorët për një shkrim fort të butë që kritikonte ish kryetarin e atëhershëm të parlamentit Skënder Gjinushi. Gazetari nuk u akuzua asnjëherë, por vizitat periodike për disa muaj në stacionin e policisë kishin lënë plagë serioze. (Gjithashtu kujtoj se praktikisht ai nuk mori asnjë mbështetje nga punëdhënësi i tij mediatik).

Më shqetësuesit nga të gjithë ishin nenet 239 deri 241 të Kodit Penal, të cilët përfshinin kohë burgimi për të pandehur të akuzuar për shpifje ndaj zyrtarëve publikë, nga shërbyesi civil më l ulët deri ndaj presidentit të republikës. Ndërkohë që qytetarët e zakonshëm që pretendonin të ishin viktima të shpifjes duhet të vepronin vetë si prokurorë, zyrtarët publikë kishin avantazhin të përfaqësoheshin nga prokurorët publikë dhe të ndihmoheshin nga policia, të cilët i ndiqnin penalisht raste të tilla si krime kundër shtetit (si në çështjen e ngritur nga Z. Gjinushi). Kjo që një shpifje subversive me fytyrë moderne.

Në vitet e fundit, megjithatë, ndjekjet penale ranë në masë të madhe për shkak të stigmës politike lidhur me figurat publike që përpqeshin të dërgonin gazetarë dhe kritikë të tjerë në burg. Edhe në rastet kur u ngritën çështje penale, ato në përgjithësi kanë rezultuar në gjoba dhe dënime të pezulluara, sesa burgime të kryera. Megjithatë, në të njëjtën kohë, politikanët dhe të tjerë zbuluan fuqinë e padive civile për shpifje për të shkaktuar dëme serioze financiare ndaj kritikëve të tyre.

Në këtë drejtim, nuk ka ndihmuar fakti që Kodi Civil përmbante vetëm disa nene të vakëta dhe pak udhëzime për gjyqtarët, mbi aplikimin e dëmeve të ashtë-quajtura morale ose jopasurore për dëmtim të reputacionit. Në mungesë të rregullimit të duhur, dhe përballë mosmarrëveshjeve shumë partiake, gjyqtarët filluan të vendosnin dëmshpërblime në dhjetëra mijëra euro në çështje kundërshtish të thella politike. Për të sjellë vetëm një shembull të kohëve të fundit, një anëtare e parlamentit nga PD, Albana Vokshi, paditi disa deputetë të opozitës për akuzat e ngritura mbi dështimin për të deklaruar pasuritë e saj si dhe supozimet e ngritura për biznese të dyshimta me qeverinë. Vendimi në një nga çështjet e para për të cilat pati vendim, kundër

⁷ Ky fragment është shkëputur nga artikulli i Darian Pavlit “Vrapimi i maratonës: përpjekje për të reformuar ligjet e Shqipërisë për shpifjen,” prill 2013, <http://institutemedia.org/Documents/PDF/D.Pavli%20shqip%20follow-up.pdf>

deputetit të PS Saimir Tahiri, çoi në dhënien e dënimit për shkaktim dëmi me 3.3 milionë lekë (më shumë se 23.000 euro), e reduktuar në apel në një milionë lekë (të barabartë me rreth shtatë paga mujore të një deputeti shqiptar). Dëmshpërblimet jashtë kontrollit dhënë nga gjykatat në çështjet civile, pa vrarë shumë mendjen për implikimet lidhur me lirinë e fjalës, siguruan një tjetër arsyetim urgjent për reformimin e ligjeve civile për shpifjen.

Edhe pse ndryshimet për në Kodin Penal dhe Kodin Civil për shpifjen dhe fyerjen ishin një risi pozitive për lirinë e mediave, ky është vetëm hapi i parë në këtë drejtim. Hapi i radhës ka të bëjë me mënyrën se si gjykatat do ta përdorin këtë ligj. Edhe pse kanë kaluar tre vite nga ndryshimi i ligjit, mbetet një periudhë e shkurtër për të krijuar një bazë të mirë të praktikës së gjykatave në këtë fushë. Gjithsesi, duke patur parasysh se mënyra se si ndryshimet interpretohen nga gjykatat është një gur i rëndësishëm prove për këtë ligj dhe për lirinë e fjalës në përgjithësi, monitorimi në fjalë ka për qëllim të hedhë një hap në këtë drejtim.

Objekt i monitorimit kanë qenë vendimet e Gjykatës së Tiranës për rastet e sjella në këtë gjykatë me të paditur gazetarë ose organe mediatike, për raste që kanë të bëjnë me shpifjen dhe fyerjen. Pra, monitorimi nuk vëren në përgjithësi se si gjykatat e zbatojnë këtë ligj, por se si ai zbatohet në raste kur në gjyq është media, për të parë se si mund të ndikojë praktika gjyqësore në lirinë e medias. Edhe pse Kodi Civil ka hartuar një listë shteruese të rrethanave që gjykata në kështu rastesh duhet të ketë parasysh për të marrë vendimin, disa nga kriteret e konsideruara në këtë monitorim janë si më poshtë:


- prirjet e vendimeve të gjykatave në raste kur media akuzohet për shpifje apo fyerje
- prirjet për ndëshkim të medias në rastet kur shpallet fajtoresh për shpifje apo fyerje
- marrja në konsideratë e faktorëve specifikë dhe joshterues që duhet të ketë parasysh gjykata
- citimi i praktikës së Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut në arsyetimin e vendimit
- prirjet e vendimeve të gjykatave të shkallëve të tjera nëse këto raste kanë vazhduar përtej shkallës së parë

Monitorimi ka përfshirë vendimet e marra në lidhje me shpifjen dhe fyerjen në vitin 2013, 2014, e deri në qershor 2015. Një kufizim i monitorimit është fakti që nuk janë përfshirë gjykatat e rrethëve të tjera, të cilat mund të rezultojnë edhe më problematika. Gjithsesi, është një hap fillestar për të parë zbatimin e ligjit në këtë fushë

▪ ***Vështrim i përgjithshëm për vendimet për shpifjen dhe fyerjen***

Gjatë monitorimit është vënë re se Gjykata e Tiranës në periudhën e monitorimit ka shpallur 42 vendime në lidhje me shpifjen dhe fyerjen, ku i paditur ka qenë një organ mediatik ose gazetar. Gjithashtu ka edhe dy raste ku organi mediatik ka qenë palë e tretë, pra kur media ka botuar një artikull apo intervistë të dikujt që nuk është punonjës i asaj media, i cili/ e cila është akuzuar


për shpifje dhe fyerje. Grafiku i mëposhtëm tregon shpërndarjen e vendimeve në këtë periudhë sipas viteve:



Si mund të shihet nga grafiku, ka një rritje të vendimeve për vitin 2014, gjithsej 19, në krahasim me një vit më parë. E njëjta prirje vërehet edhe për vitin 2015, ku për gjashtë muajt e parë janë dhënë 10 vendime. Gjithsesi, është vështirë të përshkruhet me saktësi një prirje për këtë shpërndarje, duke pasur parasysh proceset e zgjatura të gjyqimit. Të gjitha çështjet kanë qenë padi civile.

- ***Vendimet e gjykatës përballë medias***

Një nga aspektet më të rëndësishme të konsideruara gjatë monitorimit ka qenë prirja që ka gjykata për të marrë vendime në rastet kur në bankën e të akuzuarit është media, duke qenë se ndjershmëria është më e lartë, ashtu si mund të jetë dhe dëmi. Grafiku i mëposhtëm përmbledh vendimet e gjykatës në këto çështje:



Vendimet e marra nga gjykata janë ndarë në katër kategori:


- nëse vendimi është në favor të medias
- nëse vendimi është kundër medias
- nëse çështja është pushuar
- nëse akuzat ndaj medias janë pranuar pjesërisht

Si mund të shihet, gjykatat kanë pasur tendencën të favorizojnë median në vendime të tyre, pasi 11 e kanë shpallur median të pafajshme për akuzat në fjalë, krahasuar me 3 raste kur gjykata ka menduar të arsyeshme që media të shpallet fajtoare. Megjithatë, kjo prirje duhet parë me një lloj rezerve, pasi në 11 akuzat e pranuar pjesërisht nga gjykata, një pjesë e vendimeve janë kundër medias.


Duhet vënë në dukje gjithashtu se një pjesë e mirë e çështjeve janë mbyllur që në fillim, për arsye të ndryshme që nuk kanë të bëjnë me shprehje gjykimi për fajësinë e medias nëse ka patur shpifje apo jo. Arsyet më të zakonshme për përfundimin e këtyre çështjeve kanë qenë: vendimi i palës paditëse për të hequr dorë, mosparaqitja e palës paditëse, kthimi i akteve palës paditëse për plotësim dhe mosvazhdimi i procesit. Pra, në 17 nga 42 raste ka qenë kryesisht pala paditëse që ka hequr dorë nga këto çështje, që jo patjetër e bën median më pak apo më shumë fajtoare.


Tabelat e mëposhtme paraqesin prirjen e vendimeve të ndara sipas viteve:

Vendimet e vitit 2013



Vendimet e vitit 2014






Edhe këtu nuk mund të vihet re një prirje e qartë për qëndrimin e gjykatës pro apo kundër medias në rastet e shpifjes dhe fyerjes. Kështu, në vitin e parë kemi 2 raste pro dhe asnjë kundër. Në vitin 2014 kemi një rast kundër, por edhe 8 raste në favor, ndërkohë që në 2015 deri në qershor kemi vetëm një rast pro dhe 2 kundër. Në të njëjtën kohë, një pjesë e mirë e çështjeve janë pushuar, ndërsa duhet parë më me imtësi se si janë vendimet që i kanë pranuar akuzat pjesërisht. Gjithsesi, çdo përgjithësim në këtë rast për të identifikuar një prirje të përgjithshme të gjykatave në këtë drejtim do të ishte i pasaktë, pasi gjykimi duhet parë për çdo rast.

- ***Prirjet e dëmshpërblimeve të caktuara***

Përtej gjykimit nëse është vendosur në favor apo kundër medias, një aspekt tejet i rëndësishëm është se cilat janë prirjet për të vendosur dëmshpërblime në rastet kur media është konsideruar fajtorë për shpifje apo fyerje. Këtu duke pasur parasysh që media të vogla mund të vihen në vështirësi të mëdha financiare nëse përballen me një dëmshpërblim të konsiderueshëm për të shlyer.



Në 13 raste kur gjykata ka vendosur se media është fajtores për shpifje apo fyerje, në 2 prej tyre është konsideruar të jepet vetëm detyrimi për përgënjeshtim, ndërsa në dy të tjera si përgënjeshtimi, ashtu dhe dëmshpërblimi. Në shumicën e rasteve është gjykuar se media duhet të paguajë dëmshpërblim për ato që janë botuar apo transmetuar në media.





Tabela e mësipërme tregon se praktika gjyqësore varion në mënyrë të konsiderueshme në çmimin e dëmit që mendohet se është shkaktuar nga media. Natyrisht, kjo duhet parë për çdo rast të gjykuar dhe varet edhe nga masa që kërkohet nga akuzuesi. Për shembull, ka raste, kur vetë akuzuesi kërkon një shumë simbolike, si 1 Lek, pra vetëm shpagimin moral për dëmin që mendohet se i është bërë. Në vendimet e shqyrtuara dëmshpërblimi më i vogël i dhënë është 1

Lek, ndërsa më i larti është 75000 Euro, në rastin e Sokol Olldashit kundër Bolino, Basha dhe Murati.

- **Prirjet për vazhdimësinë e vendimeve**



Një tjetër element i konsideruar gjatë monitorimit ka qenë se sa nga rastet e shqyrtuara janë apeluar, ose më saktë për sa nga këto raste Gjykata e Apelit ka marrë vendim, pasi proceset gjyqësore zgjasin në mënyrë të konsiderueshme dhe periudha e monitorimit është e shkurtër. Kështu, nga rastet në shqyrtim ka pasur 10 vendime të Gjykatës së Apelit. Prirja kryesore është që edhe Gjykata e Shkallës së Dytë të lërë në fuqi vendimin që është marrë në Gjykatën e Tiranës. Kështu, në 7 nga 10 raste, Gjykata e Apelit e ka cilësuar të drejtë vendimin e marrë. Në dy raste të tjera Gjykata e Apelit ka marrë vendim në favor të medias, duke rrëzuar padinë, ndërsa vetëm në një rast Gjykata ka rritur masën e dëmshpërblimit kundër medias. Rastet në shqyrtim në këtë monitorim nuk janë gjykuar në Gjykatën e Lartë.

- **Marrja parasysh e praktikës së GJEDNJ**

Një kriter i rëndësishëm në studimin e vendimeve të gjykatave në çështjet e shpifjes ka qenë tendenca për të marrë parasysh praktikën e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Në

rastet kur ka një vendim të arsyetuar gjatë, kryesisht gjykata i referohet Kushtetutës dhe ligjeve të vendeve. Megjithatë, për raste kur gjykata është ndalur më gjatë, ka referenca në rritje ndaj praktikës së gjykatës europiane. Kështu në 10 raste të këtij monitorimi ka referenca në këtë praktikë. Kjo është një prirje e konfirmuar edhe nga një studim tjetër i ngjashëm: “gjkatat bëjnë referim të vazhdueshëm tek jurisprudenca e GJEDNJ, madje edhe në rastet kur përfundimi në të cilin kanë arritur gjykatat shqiptare ka qenë i ndryshëm nga praktika e referuar. Megjithatë, kjo gjë, pavarësisht shkallës dhe thellësisë së referimit, padyshim tregon për rritje të ndërgjegjësimit të gjyqtarëve të zakonshëm tek detyrueshmëria e jurisprudencës së GJEDNJ dhe rolit që ka kjo e fundit për mbrojtjen e të drejtave të individit edhe me vendime që jepen ndaj shteteve të tjera.”⁸

Përfundimet

Është ende herët për të dhënë një gjykim të konsoliduar për praktikën gjyqësore shqiptare në lidhje me rastet e shpifjes dhe fyerjes dhe për efektin që kjo praktikë ka në lirinë e medias dhe të shprehjes. Rastet që përfshijnë median nuk janë të shumta dhe një pjesë e mirë nuk arrijnë të gjykohen, pasi janë pushuar nga tërheqja e palës paditëse. Gjithsesi, mund të thuhet se në përgjithësi gjykata shqiptare ka pasur tendencën të jetë e ndjeshme ndaj lirisë së shprehjes dhe në shumicën e rasteve ka vendosur në favor të medias, tendencë që është konfirmuar edhe në Gjykatën e Apelit. Gjithsesi, mbetet në dorë të gjykatësit llogaritja e dëmshpërblimit në rastet kur media është fajtores, gjë për të cilën nuk ka një mekanizëm të caktuar. Kjo ndoshta është një nga fushat që duhet patur në vëmendje të vazhdueshme në vijim.

⁸ Instituti për Studime Publike & Ligjore, “Praktika gjyqësore në çështjet e shpifjes,” 2015.